



Në bazë të nenit 42 të Statutit të Kolegjit AAB dhe nenit 14, 15, dhe 16 të Rregullores së punës të Qendrës për Aftësim Profesional dhe Inovacion, Rektori i Kolegjit AAB nxjerrë këtë:

V E N D I M

për kompensimin e autorëve, trajnerëve dhe personelit të Qendrës për Aftësim Profesional dhe Inovacion

Neni 1

Autorët e kurseve të Qendrës dhe fasilitatorët e trajnimeve do të kompensohen për punën e tyre në kuadër të aktiviteteve të Qendrës sipas dispozitave në vijim.

Neni 2

Koeficienti: Koeficienti bazë i kompensimit është çmimi standard i orës mbinormë në AAB – që është e barabartë me 25 euro.

Neni 3

Llojet e kompensimit:

Janë dy tarifa të kompensimit:

- 3.1.një për personelin e rregullt të AAB – që është në nivelin 0.75 % të vlerës së orës së plotë të angazhimit sipas koeficientit të mbinormës dhe
- 3.2.një për personelin e jashtëm – që është në nivelin 100 % të vlerës së orës së plotë të angazhimit sipas koeficientit të mbinormës.
- 3.3.Bashkëpunëtorë të jashtëm konsiderohen personat që punojnë me marrëdhënie të pjesshme në AAB dhe ata që nuk punojnë në AAB.

Neni 4

Tarifat sipas niveleve: Tarifa përkatëse do të aplikohen për nivele të ndryshme të programeve të aftësimit: niveli bazik (tarifa 1 me 1), niveli profesional (tarifa 1 me 1.5), dhe niveli i avancuar (tarifa 1 me 2).

Neni 5

Hartimi i kursit nënkupton përgatitjen e silabusit, aktiviteteve dhe materialeve për aftësim, në pajtim me kriteret e parashtruara në nenet 16, 17, dhe 18 të Rregullores së Qendrës.

Neni 6

Pagesa për hartimin e kurseve është pagesë e njëhershme - realizohet vetëm një herë me rastin e dorëzimit dhe pas miratimit të kursit nga ana e Këshillit Profesional të Qendrës.

Neni 5

Pagesat për zbatimin e kurseve zbatohen pas zbatimit të kurseve dhe pas dorëzimit të fletë-vlerësimeve të vijuesve nga ana e trajnerit.

Neni 7

Tabela në vijim paraqet kriteret për kompensim sipas aktiviteteve dhe niveleve të angazhimit

Aktiviteti	Kurs fillestar / bazik	Kurs profesional	Kurs i avancuar
Për hartimin e kursit			
Për autorë të jashtëm	1/1 orë mësimore	1/1.5 orë mësimore	1/2.0 orë mësimore
Për autorë nga AAB	1/1 orë mësimore	1/1.5 orë mësimore	1/2.0 orë mësimore
Për trajnim / zbatim			
Për autorë të jashtëm	1/1 orë mësimore	1/1.2 orë mësimore	1/1.5 orë mësimore
Për autorë nga AAB	1/0.75 orë mësimore	1 / 1 orë mësimore	1/1.2 orë mësimore
Organizimi	1/0.1 orë mësimore	1/0.1 orë mësimore	1/0.1 orë mësimore

Neni 8

Shpjegim i tabelës:

1/1 domethënë se për një orë trajnim autori / fasilitatori paguhet sa vlera e pagesës për një orë mësimore (mbinormë) për personelin përkatës. Domethënë, nëse ora mbinormë është 25 euro, 1/1 nënkupton 25 euro dhe aftësimi prej katër orësh kompensohet në shumën 100 euro.

Për stafin me kontratë të plotë në AAB, kompensimi do të ishte 0.75 domethënë 18.75 euro ora e trajnimit në vend të 25 euro ora.

Pagesat për nivelet më të larta të kurseve (profesional dhe i avancuar) bëhen sipas tabelës më lartë.

Dr.sc. Bujar Demjaha, Rektori

